



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura V**

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 94

Prishtinë, më 23.02.2017, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S/1

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Selvije Halimi, Danush Ademi, Agim Ademaj, Armend Zemaj, Nezir Çocqj, dhe Doruntinë Maloku,

**Munguan: albulena haxhiu,** Agim Aliu, Valdete Bajrami, Pal Lekaj dhe Milena Miliçević

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Agron Gashi KosovaPress, Taulant Osmani Kallxo.com, Norë Shabani Koha Ditore, Beadin Sylja KosovaPress, Lumnije Murati ZPRK, Fitore Ademi RTV21, Granit Berisha praktikant, Gjelbrime Hasani praktikante, Albulena Raçi praktikante, Sanije Berisha OSCE, Dren Ajeti GSJP, Alban Muriqi QKRMT..

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci, Fatbardha Boletini;

**Mbledhjen e kryesoi,** Selvije Halimi, Nën-kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me 17 dhe 24 janar 2017;
3. Njoftim me shpresën e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me rastin KO12/17;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin 05/L-134 për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive;
5. Formimi i grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit nr. 05/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve penale;

6. Formimi i grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit nr. 05/L-135 për Ndërmjetësim;
7. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës.**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

**2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me 17 dhe 24. janar 2017**

*Kryesuesja konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 17 dhe 24 janar 2017 pa vërejtje.*

**3. Njoftim me shkresën e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me rastin KO12/17;**

**Selvije Halimi-** njoftoi komisionin me shkresën e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me rastin KO12/17, ku tha se komisioni duhet të përgadisë një përgjigje deri me datën 3 mars lidhur me këtë çështje. Ajo propozoi që përberja e grupit punues të jetë e njëjtë me atë që ka marrë pjesë në procesin e amendamentimit të ligjit për kundërvajtje.

*Meqë nuk kishte mospajtime në lidhje me këtë çështje komisioni njëzëri nxorri këtë:*

**V e n d i m**

**Formohet grupi punues për përgatitjen e përgjegjës për Gjykatën Kushtetuese për rastin KO-12/17 në përbërje:**

Armend Zemaj, kryesues;  
Agim Aliu, anëtar; dhe  
Danush Ademi, anëtar.

**4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin 05/L- 134 për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive;**

**Nen-kryetarja-** Selvije Halimi paraqiti para komisionit raportin me amendamente të Komisionit funksional në Projektligjin 05/L- 134 për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje;

*Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se komisioni në mënyrë unanime, vendosi që kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

**REKOMANDIM**

1. Projektligji nr. 05/L- 134 për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe mjeteve eksplozive dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me

Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

**5. Formimi i grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit nr. 05/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve penale;**

Komisioni vendosi që për shqyrtimin e Projektligjit nr. 05/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale të formojë një grup punues në këtë përbërje:

Armend Zemaj-kryetar  
Albulena Haxhiu-anëtare  
Agim Aliu-anëtar  
Danush Ademi-anëtar

**6. Formimi i grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit nr. 05/L-135 për Ndërmjetësim;**

Komisioni vendosi që për shqyrtimin e Projektligjit nr. 05/L-135 për Ndërmjetësim të formojë një grup punues në këtë përbërje:

Nezir Çoçaj-kryetar  
Agim Ademaj-anëtar  
Doruntina Maloku-anëtare  
Albulena Haxhiu-anëtare

**7. Të ndryshme.**

Në këtë pikë të rendit të ditës nuk kishte diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 13:20  
E përgatiti:  
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Nen-kryetarja e Komisionit,

---

**Selvije Halimi**